



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE  
INOVACIONIT**

**DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE**

**UDHËZUES**

**PËR**

**PROJEKTET E TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (PTI)  
(Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin)**

**Viti 2023**

## Përmbajtja

### **KREU I**

<b>QËLLIMI, SYNIMI, OBJEKTIVAT DHE KRITERET E PRANUESHMËRISË</b> .....	4
1.1.Rreth Programit të Teknologjisë dhe Inovacionit .....	4
1.2 Qëllimi i PTI .....	4
1.3.Synimi i PTI.....	5
1.4. Objektivat PTI.....	5
1.5.Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve .....	6

### **KREU II**

#### **PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE** .....

2.1.Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte.....	7
2.2.Dokumentacioni i aplikimit .....	7
2.3.Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit .....	7
2.4.Shqyrtimi i dosjes së aplikimit .....	7
2.5.Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit .....	8
2.6.Njoftimi i fituesve .....	8

### **KREU III**

#### **VLERËSIMI DHE FINANCIMI I PROJEKTEVE** .....

3.1. Procedurat e vlerësimit .....	8
3.2. Procesi i vlerësimit.....	8
3.3. Procedurat e miratimit për financim të projekteve .....	9
3.4. Financimi i projekteve fituese.....	9
3.5. Buxheti i detajuar .....	9

### **KREU V**

#### **PROCEDURA E MONITORIMIT TË PROJEKTEVE** .....

4.1. Qëllimi i monitorimit .....	10
4.2. Fazat e monitorimit .....	11
4.3. Detyrimet e aplikantit .....	11
4.4. Raportet e monitorimit.....	11
4.5. Raporti Final .....	11

### **KREU V**

#### **Etika, Pronësia Intelektuale, Konflikti i interesit dhe Konfidencialiteti**

5.1.Etika dhe Integriteti.....	12
5.2. Pronësia Intelektuale.....	13
5.3.Konflikti i interesit dhe konfidencialiteti.....	13

### **KREU VI**

#### **Dispozita të përgjithshme**

<b>6.1. Kohëzgjatja e projektit</b> .....	13
<b>6.2. Forma/fokusi i PTI</b> .....	13

## **ANEKSET**

<i>Aneks 1</i> - Modeli i dokumentit për aplikim .....	15
<i>Aneks 2</i> - Formulari i Buxhetit .....	19
<i>Aneks 3</i> - Sqarime për plotësimin e Dokumentit të PTI dhe Formularit të Buxhetit.....	20
<i>Aneks 4</i> - Lista e dokumentave të paraqitura bashkë me Projekt Propozimin.....	23

## KREU I

### QËLLIMI, SYNIMI, OBJEKTIVAT DHE KRITERET E PRANUESHMËRISË

#### 1.1. Rreth Programit të Teknologjisë dhe Inovacionit

Programi i financimit të projekteve të bashkëpunimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë me industrinë dhe biznesin synon intensifikimin e bashkëpunimit midis biznesit dhe komunitetit të kërkimit shkencor nëpërmjet granteve të përbashkëta për zgjidhjen racionale të problematikave të zhvillimit të biznesit në transferim teknologjie dhe inovacion, në kuadër të zbatimit të objektivave strategjike kombëtare në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Ai është në një linjë edhe me prioritetet strategjike të Zonës Europiane të Kërkimit (ERA) dhe kërkesat e integritit european të vendit.

Financimi i projekteve të përbashkëta që vijnë si bashkëpunime të komunitetit të kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë me industrinë dhe biznesin kanë për qëllim ndërtimin e lidhjeve më të ngushta ndërmjet biznesit dhe universiteteve në mënyrë që të bashkëprodhojnë njohuri dhe kërkime me një ndikim jo vetëm akademik, por edhe të zbatueshëm për zhvillimin e Shqipërisë në një linjë me kërkesat e integritit european dhe sfidave të shumta aktuale.

#### 1.2. Qëllimi

Ky udhëzues shërben për projektet e përbashkëta që vijnë si bashkëpunime të komunitetit të kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë me industrinë dhe biznesin në kuadër të fondit të Teknologjisë dhe Inovacionit. Projektet e Teknologjisë dhe Inovacionit (këtu e në vijim PTI - Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin) realizohen mbi baza bashkëfinancimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) me grant të buxhetit të shtetit dhe të sipërmarrjeve të industrisë dhe biznesit, dhe administrohen nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

Qëllimi i programit është të intensifikojë përpjekjet për kërkim dhe zhvillim (R&D), të forcojë ndërlidhjen midis institucioneve të arsimit të lartë dhe industrisë dhe të përshpejtojë zhvillimin nga faza laboratorike në fazën pilot, duke i bërë ato të përshtatshme për komercializim.

### **1.3. Synimi i PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin)**

Synimi i PTI është promovimi dhe mbështetja e projekteve të përbashkëta të komunitetit të kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë me industrinë dhe biznesin, në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit, si dhe me tendencat e zhvillimeve globale, duke e vënë punën kërkimore-shkencore në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit.

### **1.4. Objektivat e programit PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin)**

Objektivat e programit janë:

- a. Të mbështesë kërkimin shkencor dhe inovacionin në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale sipas fushave prioritare të miratuara nga MAS.
- b. Të nxisë inovacionin dhe zhvillimin teknologjik nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë me komunitetin e industrisë dhe biznesit;
- c. Të vendosë kërkimin shkencor në qendër të zgjidhjes së problemeve të biznesit dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit;

### **1.5. Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve**

1. Të drejtën për të aplikuar me projekte të përbashkëta PTI (që vijnë si bashkëpunime të institucioneve të arsimit të lartë (IAL-ve) me biznesin, e kanë IAL që, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, zhvillojnë kërkim shkencor.
2. Aplikuesi i parë do të jetë një IAL i përcaktuar si i tillë në pikën 4, të Nenit 4, të Ligjit Nr. 80/2015, në partneritet me një biznes, partneritet i cili sanksionohet me një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre. Pjesë e marrëveshjes duhet të jetë bashkëfinancimi në raportin 70% financim grant nga AKKSHI dhe 30% financim nga biznesi.
3. Aplikant i dytë i referuar si partner nga biznesi, duhet:

- a) Të jetë i organizuar dhe të funksionojë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, specifikisht me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2018 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
  - b) Të ketë selinë dhe të ushtrojë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
  - c) Të shprehë qartë përfitimin nga projekti i propozuar ne partneritetet me kërkusit shkencor pjesë e IAL dhe të dëshmojë kapacitete në mbështetje të projektit;
4. Projektet duhet të synojnë zhvillimin e një produkti/procesi/shërbimi të ri, ose përmirësime të dukshëm në një product/proces ekzistues/shërbim, me potencial tërheqës tregu.
  5. Projekt propozimi duhet të mbështetet mbi një Plan-Biznesi me specifikime të qarta lidhur me rezultatet e pritëshme të projektit.
  6. Projekt propozimi duhet të përputhet me prioritetet strategjike kombëtare dhe sektoriale të miratuara nga Qeveria Shqiptare, sipas fushave të mësipërme.
  7. Projekt propozimi duhet të vijë nga një grup kërkuesish në një IAL sipas përcaktimeve të mësipërme, në përputhje me kërkesat udhëzuesit përkatës të PTI;
  8. Projekt propozimi duhet të përmbajnë vetëm veprimtari që lidhen me kërkim&zhvillimin, duke përjashtuar blerjen e pajisjeve, reagentëve, mjeteve, etj. Infrastruktura e nevojshme ofrohet nga biznesi si partner aplikues;
  9. Objektivat e Projekt propozimit duhet të synojnë:
    - a) Zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovative;
    - b) Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë dhe biznesit;
    - c) Lehtësimin e komercializimit të produktit;
    - d) Projekti duhet të ketë në bazë veprimtarinë kërkimore që ka për synim: (i) përmirësimin e zinxhirit të vlerës, (ii) përmirësimin e produktit; (iii) përmirësimin e shërbimit apo të zhvillojnë konceptin e biznesit për një produkt apo shërbim që është i gatshëm të dalë në treg, në përputhje me strategjinë e rritjes e fuqizimit të kompanisë.

## **KREU 2**

### **PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE.**

#### **2.1. Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte.**

Bordi i Administrimit (BA) i AKKSHI-së miraton hapjen e thirrjes për aplikim me projekte të PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin). Vendimi i BA publikohet në faqen zyrtare web dhe media sociale të AKKSHI dhe është i aksesueshëm për gjithë të interesuarit.

#### **2.2. Dokumentacioni i aplikimit**

Dokumentacioni për aplikim për projekte hartohet nga AKKSHI dhe është i aksesueshëm në faqen zyrtare web të institucionit për të gjithë institucionet që janë të interesuar dhe kanë të drejtën të aplikojnë për projekte të PTI.

Aplikantët paraqesin kërkesën për financim në formën e një projektpropozimi shoqëruar edhe me shkresë zyrtare përcjellëse nga institucioni që aplikon. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në AKKSHI nëpërmjet protokollit në 2 (dy) kopje fizike dhe 1 kopje në formë elektronike.

Projekt-propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Formës së Aplikimit të Projektit për Bashkëpunim IAL-Biznes (Aneks 1) dhe Formës së Propozimit Financiar (Aneks 2).

#### **2.3. Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit**

Dosja e aplikimit me projektpropozimin, duhet të depozitohet në AKKSHI brenda afatit të përcaktuar në Thirrjen për aplikim të shpallur nga AKKSHI.

Përcaktimi i afateve për depozitim të aplikimit kryhet në përputhje me përcaktimet kuadrit ligjor në fuqi.

#### **2.4. Shqyrtimi i dosjes së aplikimit**

Në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, kontrolli formal bëhet nga Drejtoria e Programeve Kombëtare, në Sektorin e Teknologjisë dhe Inovacionit, që administron PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin). Ai synon të vlerësojë nëse projektpropozimi është formuluar në përputhje me Modelin e Formatit të Aplikimit të projektpropozimit. Projekt-

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Adresa: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë. Email: info@nasri.gov.al

propozimet që nuk kanë dokumentacion të plot, kanë pasaktësi në plotësim, apo që nuk përmbushin kriteret dhe formatin e përcaktuar nga AKKSHI, skualifikohen.

## **2.5. Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit**

Projektpropozimet të cilat i janë përmbajtur kriterëve administrative të vendosura nga AKKSHI së bashku me dokumentacionin përkatës, kalojnë në procesin e vlerësimit teknik nga komisionet e vlerësimit të projekteve.

## **2.6. Njoftimi i fituesve**

Pasi vlerësohen nga komisionet e ekspertëve të vlerësimit dhe pasi miratohen nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, projektet të cilat shpallen fituese njoftohen me shkresë zyrtare dhe gjithashtu shpallja e fituesve bëhet edhe në faqen zyrtare të internetit të AKKSHI.

# **KREU 3 VLERËSIMI DHE FINANCIMI I PROJEKTEVE**

## **3.1. Procedurat e vlerësimit**

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të drejtimit të çdo aktiviteti shkencor. Atij i nënshtrohen të gjitha Projektet për Bashkëpunim IAL-Biznes.

Ai nevojitet për të evidentuar gjendjen reale të ecurisë së projekteve dhe për të përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e saj, për të nxjerrë përfundime të drejta lidhur me vlerën e vetë projekteve, rezultatit shkencor të projektit, problemet administrative, financiare si dhe mësimet në lidhje me projektet e ardhshme.

## **3.2 Procesi i vlerësimit**

Procesi i vlerësimit fillon me kontrollin teknik formal e administrativ që kryhet nga stafi i Drejtorisë së Programeve Kombëtare në AKKSHI dhe synon përmbushjen e kriterëve të aplikimit dhe të dokumentacionit që aplikantët kanë paraqitur.

Projekt-propozimet që kalojnë fazën e parë i përcillen për ekspertizë Komisionit të Ekspertëve, që bën vlerësimin përmbajtësor e shkencor të tyre. Kriteret bazë të përzgjedhjes gjatë vlerësimit janë:

- Impakti;
- Ekselencia;
- Cilësia dhe efektiviteti i zbatimit



### **3.3 Procedura e miratimit për financim të projekteve**

Procesi i miratimit për financim të projektit pason procesin e vlerësimit dhe kalon përmes këtyre hapave:

a. Marrja e Vendimit.

Vlerësimet e Komisionit të Ekspertëve i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI me procesverbalin përkatës të mbajtur nga çdo komision dhe listën me renditjen e projekteve sipas mesatares të pikëve të firmosur nga ekspertët vlerësues. Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI e paraqet listën për miratimin e projekteve fituese në Bordin e Administrimit.

b. Lidhja e Kontratës.

Nëse projektpropozimi miratohet për financim nga Bordi i Administrimit, lidhet kontrata ndërmjet AKKSHI dhe institucionit të arsimit të lartë të përfaqësuar nga përfaqësuesit ligjorë përkatës.

### **3.4. Financimi i projekteve fituese**

Pas vlerësimit nga ekspertët e Komisioneve të vlerësimit dhe pas miratimit të projekteve fituese në Bordin e Administrimit, përfituesi do të marrë fondin e përcaktuar, brenda afatit që përcaktohet në kontratë.

Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak nga Bordi i AKKSHI-së.

Zgjatja në kohë e projektit ndodh vetëm pas një kërkesë nga përfituesi e dërguar të paktën 7 (shtatë) ditë përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga Bordi i AKKSHI-së. AKKSHI njoftohet menjëherë në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet dhe numrin e llogarisë së përfituesit.

Ndryshimet në zërat buxhetore lejohen deri në një total prej 10 % të fondit të financuar nga AKKSHI-ja dhe mund të bëhen pa miratimin paraprak. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim AKKSHI-në .

### **3.5 Buxheti i detajuar**

Projekt – propozimet vijnë si bashkëfinancim në raportin 70% financim grant AKKSHI dhe 30% financim nga sipërmarrja/biznesi. Pas miratimit për financim nga BA, drejtuesi i projektit risjell Planin e Financimit të detajuar të projektit sipas *Aneksit 2*.

Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me aktivitetet në kuadër të projektit. Pagesat e

personelit të angazhuar në grupin e punës së projektit duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi<sup>1</sup> si dhe me udhëzimin përkatës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit<sup>2</sup>.

Shpenzimet administrative brenda miratimit të buxhetit limit, nuk duhet të lidhen me funksionimin e përgjithshëm të institucionit/sipërmarrjes dhe duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të projektit. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financon Projektin:

- a. Blerje e tokës.
- b. Shit-blerje makinash.
- c. Interes mbi huadhënie.
- d. Marrëveshje huadhënie.
- e. Dhurime.
- f. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare.
- g. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit.
- h. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

## **KREU 4**

### **PROCEDURA E MONITORIMIT TË PROJEKTEVE**

#### **4.1. Qëllimi i monitorimit**

Procesi i monitorimit fokusohet në dy drejtime kryesore: a) në verifikimin e zbatimit të projektit sipas planifikimit të projektit të miratuar për financim; b) në shqyrtimin e raporteve të drejtuesve të projekteve mbi ecurinë e projekteve.

AKKSHI nuk ka funksion të saj auditimin financiar të fondeve që janë përfituar nga financimi i projektit.

---

<sup>1</sup> Kodi i punës i RSH

<sup>2</sup> Udhëzimi nr.29, datë/10/9/2018, " Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Adresa: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë. Email: info@nasri.gov.al

## **4.2. Fazat e monitorimit**

Monitorimi i projekteve realizohet nga grupet e ngritura me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit çdo gjashtë muaj.

## **4.3. Detyrimet e aplikantit**

Përfituesi duhet të ofrojë akses në institucion për ekspertët monitories të AKKSHI pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentet lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.

## **4.4. Raportet e monitorimit**

Pas përfundimit të monitorimeve grupi i monitorimit harton raportin përkatës për çdo projekt të financuar nga AKKSHI.

Monitorimi sqaron çështjet sipas skemës përkatëse mbi bazën e të cilës ndërtohet Raporti i Misionit të Monitorimit.

## **4.5. Raporti Final**

Raporti final bëhet për cdo projekt më vete dhe i paraqitet organit financues në përfundim të projektit. Raporti final përfshin, raportin përshkruar, raportin financiar, dhe fotografi, video të realizimit të projektit. Në raport përshkruhet realizimi i detyrave dhe rezultatet e arritura, të shprehura me tregues sasiorë dhe cilësorë, detyrat e parashikuara që nuk janë realizuar dhe probleme që mund të jenë hasur dhe realizimi i planit të financimit. Raporti final duhet të depozitohet në AKKSHI me shkresë përcjellëse.

Raporti shkencor (studimi) paraqitet sipas strukturës së mëposhtme:

- a. Kopertina sipas modelit bashkëlidhur.
- b. Përmbajtja e lëndës, ku jepet emërtimi i kapitujve e nënkapitujve dhe numri i faqeve përkatëse.
- c. Lista e shkurtimeve të termave të përdorura (Faqe më vete).
- d. Lista e ilustrimeve (figura, grafikë, harta, skica, etj.) (Faqe më vete).
- e. Hyrja.
- f. Rezultatet shkencore të projektit.
- g. Përfundime.

- h. Rekomandime.
  - i. Literatura.
- Bashkë me raportin shkencor (studimin) institucionit financues i dërgohen dhe:
- j. Situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas pasqyrave të AKKSHI.
  - k. Tabelë përmbledhëse me të dhëna për projektin e financiar.
  - l. Vlerësimi i ekspertizës së bërë nga institucioni shkencor përgjegjës për projektin.
  - m. Vendimi i Këshillit Shkencor të institucionit shkencor përgjegjës.
  - n. Skeda informative të projektit.

## KREU 5

### Etika, Pronësia Intelektuale, Konflikti i interesit dhe Konfidencialiteti

#### 5.1. Etika dhe Integriteti i Kërkimit

Aplikantët duhet të respektojnë parimet kryesore të etikës shkencore dhe asaj profesionale. Procesi i kërkimit si dhe studimi shkencor/artikujt shkencorë/ botimet shkencore/instrumentat e kërkimit/dokumentat /etj, që do të prodhohen në kuadër të këtij projekti, do të jenë në përputhje me parimet e kodit të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor kombëtar dhe europian lidhur me etikën në kërkimin shkencor<sup>3</sup>, si më poshte vijon:

- Respektimi i dinjitetit dhe integritetit njerëzor;
- Sigurimi i ndershmërisë dhe transparencës ndaj subjekteve kërkimore dhe veçanërisht marrja e pëlqimit dhe informimit;
- Sigurimi i privatësisë dhe konfidencialitetit;
- Promovimi i drejtësisë dhe i gjithëpërfshirjes;
- Minimizimi i dëmit dhe përfitimi maksimal;

<sup>3</sup> Konsiderohen shkelje të rënda të integritetit në kërkimin shkencor: fabrikimi ose sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta; falsifikimi manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja/shmangia e të dhënave ose e rezultateve, në mënyrë të pajustificuar ose prezantimi i njëpunimi ose botimi si me vlera shkencore, pa qenë i tillë; plagjiatura ose përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale; pranimi dhe/ose paraqitja e punimeve pranë një organi haptazi jo kompetent a i pa autorizuar në fushën përkatëse; manipulimi i autorësisë; autoplagjiatura; citimi përzgjedhës; fshehja e pjesshme e rezultateve të kërkimit; lejimi i financuesve/sponsorizuesve të rezikojnë pavarësinë e procesit të kërkimit ose të raportimit të rezultateve; keqprezantimi i arritjeve të kërkimit; themelimi ose mbështetja e revistave a botimeve të tjera grabitqare; fshehja e konfliktit të interesit etj.

**Referenca:**

- a. European Code of Conduct for Research Integrity-2017, burimi: <https://www.allea.org/wp-content/uploads/2017/05/ALLEA-European-Code-of-Conduct-for-Research-Integrity-2017.pdf>.

I përkthyer në gjuhën shqipe, në linkun: [https://www.allea.org/wp-content/uploads/2018/06/ALLEA-ALbanian-European-Code-of-Conduct-for-Research-Integrity\\_FINAL.pdf](https://www.allea.org/wp-content/uploads/2018/06/ALLEA-ALbanian-European-Code-of-Conduct-for-Research-Integrity_FINAL.pdf)

Projekt – ligj “Për kodin e sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, botuar në faqen zyrtare web të MASR në linkun: [http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/KODI\\_ETIK.pdf](http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/KODI_ETIK.pdf).

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Adresa: Rruga “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë. Email: info@nasri.gov.al

- Respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe gjeneratave të ardhshme, etj.

## **5.2.Pronësia Intelektuale**

Sipërmarrja e biznesit dhe institucioni i arsimit të lartë partner në projekt duhet të tregojnë vëmendje të veçantë për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale dhe të paraqesin evidencë bindëse apo masat për të garantuar mundësinë e shfrytëzimit komercial të produktit apo shërbimit inovativ që ka krijuar ( shpesh herë e njohur si liria për të vepruar (angl. freedom to operate)).

## **5.3. Konflikti i interesit dhe konfidencialiteti**

Si pjesë e procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, AKKSHI do të ndajë përmbajtjen e aplikimeve për grante me ekspertë të brendshëm dhe/ose të jashtëm për të vlerësuar meritat e secilit aplikant dhe respektimin e kërkesave të përshkruara në këtë program. AKKSHI do të përpiqet të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të dhënë në një aplikim, por *aplikanti është përgjegjës për identifikimin specifik të të gjitha informacioneve konfidenciale brenda aplikimit për të cilat ai gjykon që nuk duhet të ndahen me të tjerë*. Nëse gjykohet e nevojshme nga paneli shqyrtues, aplikantëve mund t'u kërkohet të dorëzojnë informacione ose dokumentacion shtesë dhe/ose të paraqesin propozimin e tyre dhe informacione të tjera relevante të shqyrtuesit përpara se të merret një vendim për financimin. Në çdo rast, aplikuesit, vlerësuesit dhe stafi teknik zbaton parimet ruajtjes së konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

## **KREU 6**

### **Dispozita të përgjithshme**

#### **6.1. Kohëzgjatja e projektit**

Projektet PTI kanë një kohëzgjatje 2 (dy) vite kalendarike

#### **6.2. Forma/fokusi i PTI**

Në varësi të qëllimit dhe objektivave, mund të jetë:

- Studim fizibiliteti*. Përmes projekt-propozimit të paraqitur dhe grantit të përfituar, ju ofrohet sipërmarrjeve të biznesit mundësitë që të shqyrtojnë leverdishshmërinë ( fizibilitetin) shkencor apo teknik dhe potencial tregtar të një ideje inovatore në fushën e produkteve, shërbimeve apo modeleve të reja

të biznesit dhe për të hartuar më tej një Plan – Biznesi që do të zgjerojë e shtrijë këtë produkt inovativ në treg. Aktivitetet e përfshira në projekt-propozimin e paraqitur mund të jenë:

- analizë risku;
- studime tregu;
- përfshirja e klientëve apo përdoruesve të produktit apo shërbimit të ri;
- analiza e kuadrit rregullator e regjimit të standarteve për produktin apo shërbimin e ri;
- administrimi i aspekteve të pronësisë intelektuale, si dhe,
- gjetja e partnerëve apo vlerësimi i leverdisshmërisë (fizibilitetit)

Qëllimi i sipërmarrjeve të biznesit aplikuese do të jetë hartimi i një projekti solid me potencial të lartë inovacioni në përputhje me strategjinë Europiane apo strategjinë globale të orientuar nga tregu. Projekt-propozimi duhet të mbështetet mbi një Plan-Biznesi si dhe të hartojë specifikime në një mënyrë sa më të qartë se cili do të jetë rezultati i projektit.

### ***b.Nga Koncepti tek Tregu***

Në këtë fazë përmes grantit që i ofrohet projektit, bëhet e mundur që sipërmarrja e biznesit të zhvillojë konceptin e saj të biznesit në një produkt, shërbim apo proces që është i gatshëm të dalë në treg në përputhje me strategjinë e rritjes e fuqizimit të kompanisë tij/saj.

Në këtë fazë projekt-propozimi mund të përfshijë aktivitete të tilla si:

- eksperimentimi;
- prototipin e produkteve,
- vlerësimin,
- demonstrimin si dhe testimin e produktit,
- shërbimin apo modelin në kushte reale dhe nxjerrjen e tij në treg.

Projekt – propozimi i paraqitur, nga Koncepti tek Tregu, duhet të jetë i mbështetur një Plan Strategjik Biznesi dhe duhet të specifikojë rezultatin e projektit dhe kriterin për sukses ashtu si edhe impaktin e kompanisë në termat sasiorë e cilësorë (psh. qarkullimi vjetor, punësimi, madhësia në treg, administrimi i Pronësisë Intelektuale, pagat, rikthimi i investimit, fitimi).

### **c. Komercializimi**

Komercializimi është procesi i sjelljes së produkteve ose shërbimeve të reja në treg. Ai mund të përfshijë prodhimin, shpërndarjen, marketingun, shitjet, mbështetjen e klientit dhe funksione të tjera kyçe kritike për arritjen e suksesit tregtar të produktit ose shërbimit të ri.

# ANEKS 1

## FORMULARI I APLIKIMIT

### Forma e aplikimit për projekte PTI IAL – Biznes.

#### 1. Të dhënat e Entitetit që Aplikon për projektin e PTI IAL – Biznes.

<b>Agjencia Ekzekutive</b>	
<b>Titulli i Projektit<sup>4</sup></b> Shqip dhe Anglisht	
<b>Fusha ku aplikohet<sup>5</sup></b>	
<b>Drejtues i projektit</b>	
<b>Kohëzgjatja e projektit (në muaj)</b>	
<b>Buxheti i kërkuar nga<sup>6</sup> AKKSHI</b>	
<b>Buxheti i kërkuar/i mbuluar nga<sup>7</sup> BIZNESI</b>	
<b>Buxheti i mbuluar nga burime të tjera (Vetë IAL)</b>	
<b>Buxheti total i projektit</b>	

#### 2. Të dhënat e Drejtuesit të Projektit dhe Biznesit

##### 2.1 Të dhënat e Drejtuesit të Projektit

<b>Emër, mbiemër</b>	
----------------------	--

<sup>4</sup> Titulli i projektit duhet të shprehë në mënyrë sintetike objektin e studimit.

<sup>5</sup> Projekt-propozimi duhet të paraqitet vetëm në një nga 6 fushat prioritare siç janë specifikuar në Thirrjen për aplikim.

<sup>6</sup> Buxheti duhet të jetë i specifikuar qartë dhe të përputhet plotësisht në të dy anekset (forma e aplikimit dhe forma e propozimit financiar)

<sup>7</sup> Buxheti duhet të jetë i specifikuar qartë dhe të përputhet plotësisht në të dy anekset (forma e aplikimit dhe forma e propozimit financiar)

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Adresa: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë. Email: info@nasri.gov.al

<b>Institucioni</b>	
<b>Posti që mban</b>	
<b>Grada shkencore</b>	
<b>Adresa e e-mail</b>	
<b>Numri i celularit</b>	
<b>Adresa postare</b>	

## 2.2 Kapaciteti i drejtuesit të projektit

<b>Eksperienca në punë kërkimore</b>	
<b>Punimet shkencore të kryera në pesë vitet e fundit</b>	Listo të gjitha projektet e zbatuara si në pesë vitet e fundit)

## 2.3 Të dhënat e Biznesit

<b>Emri i Subjektit</b>	
<b>NIPTI</b>	
<b>Data e Regjistrimit</b>	
<b>Objekti i aktivitetit</b>	
<b>Data e themelimit</b>	
<b>Adresa</b>	
<b>Email</b>	
<b>Numri i celularit</b>	
<b>Adresa postare</b>	
<b>Person kontakti</b>	
<b>Email</b> (Person kontakti)	
<b>Numri i celularit</b> (Person	



kontakti)

### 3. Argumentimi shkencor i Projektit. (max 2 faqe ).

- 3.1 Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:
- 3.2 Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj ose në institucione të tjera.
- 3.3 Me cilin prioritet strategjik Sektorial lidhet projekt-propozimi juaj?
- 3.4 Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fundamentale dhe/ose të aplikuara

### 4. Qëllimi dhe objektivat e projektit (max 1 faqe) (në Shqip dhe Anglisht)

- 4.1 Qëllimi
- 4.2 Objektivat e projektit

### 5. Aktivitetet e projektit (të lidhura me objektivat) (max 2 faqe)

### 6. Metodologjia e realizimit të projektit

- 6.1 Përshkrimi i detajuar i metodologjisë së kërkimit shkencor

### 7. Rezultatet e projektit (te lidhura me objektivat dhe aktivitetet) (max 2 faqe) (në Shqip dhe Anglisht)

- 7.1 Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?

### 8. Përfituesit e projektit (Përshkruaj në mënyrë specifike cilët janë përfituesit direkt dhe indirekt të produktit të kërkimit shkencor e lidhur me fushën strategjike ku aplikohet)

- 8.1 Përfituesit direkt
- 8.2 Përfituesit indirekt

### 9. Personeli që do të përfshihet në projekt<sup>8</sup>:

Grada shkencore	Emër mbiemër	Institucioni	Detyrat në projekt

### 10. Plani i punës

<sup>8</sup> Në personelin e projektit përfshihen bashkëpunëtorët shkencorë. Në grupin e punës nuk mund të përfshihen persona që janë ekspertë të komisioneve të vlerësimit të projekteve në AKKSHI.

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Adresa: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë. Email: info@nasri.gov.al

## Kalendari i aktiviteteve

Viti 2023-2024

Objektivi	Aktiviteti <sup>9</sup>	Rezultati	Periudha kohore	Personi përgjegjës
			(Muaji x-Muaji Y)	

Aktiviteti/Muaji	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	J	SH	M

Drejtuesi i Projektit

---

Rektori i Universitetit

---

Administratori i Biznesit

---

<sup>9</sup> Aktivitetet dhe periudha kohore duhet të jenë të njejta tek të dyja tabelat.

## ANEKS 2

### FORMULARI I PROPOZIMIT FINANCIAR

ANEKS 2. Forma e Propozimit Financiar								
Forma e planifikimit të detajuar të buxhetit të projektit								
Aplikanti (Agjencia Ekzekutive): .....								
Drejtes i projektit: .....								
Titulli i Projektit: .....								
Nr.	Zërat e detajuar të shpenzimeve	Njësia	Sasia	Kosto për njësi (në Lekë)	Totali	Shuma e kërkuar nga AKKSHI	Shuma e mbuluar nga Biznesi ose nga burime te tjera	Përshkrimi i detajuar
1	Pagesë për personelin (përfshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore)							
	<a href="#">Pagat për burimet njerëzore [1]</a>							
1.1	Drejtes i projektit	ditë pune						
	<a href="#">Stafi teknik[2] (detajo)</a>							
1.2	Staf teknik 1	ditë pune						
1.3	Staf teknik 2							
1.4	Staf teknik 3							
	<b>TOTAL</b> (Shuma e shpenzimeve të planifikuara të Projektit)							
<p style="text-align: center;"> Drejtes i Projektit                      Administratori i Universiteti                      Drejtes i Zyrës së Financës                      Administratori i Biznesit  -----    -----    -----    -----    Drejtes i Agjencisë Ekzekutive  Rektori i Universitetit / Drejtori i Përgjithshëm  ----- </p>								
<p>[1] Në zërin e Burimeve Njerëzore, në çdo rast punësimi në bazë të Kodit të Punës, duhet të përfshihen edhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme për tu paguar sipas legjisllacionit në fuqi. Në tabelën shoqërore të buxhetit, duhet të jepen edhe shpjegimet dhe argumentet për domosdoshmërinë dhe funksionin për të cilën do të punësohen secili prej punonjësve në kuadër të Projektit. *Pagesat e personelit, duhet t'i referohen kontratës të punës që çdo anëtar i projektit ka në IAL ose në institucionin që aplikon për projektin.</p>								
<p>[2] Staf i teknik ndër të tjera mund të përfshijë pozicione pune si psh pedagogë, bashkëpunëtorë shkencorë, laborant, IT</p>								

## ANEKS 3

### Sqarime për plotësimin e Dokumentit të Projektit të Teknologjisë dhe Inovacionit

Plotësimi i saktë i Formularit të Aplikimit të Projekt - Propozimit të PTI sipas kërkesave të Modelit të dhënë ka rëndësi të veçantë, sepse mbi këtë dokument bazohet zgjedhja ose refuzimi i projekt-propozimit për financim. Në plotësimin e tij të mbahet parasysh sa vijon:

- a. Në krye të Dokumentit shënohet emri i IAL-së aplikuese. (IAL që aplikon që njihet si person juridik dhe që merr përsipër të gjitha detyrimet për realizimin në kohë e me cilësi të projektit.)
- b. Shënohet emri i plotë dhe i saktë i sipërmarrjes së biznesit që është partner në projekt me të cilën Agjencia Ekzekutuese (IAL) ka nënshkruar marrëveshje partneriteti dhe bashkëfinancimi para paraqitjes së projekt-propozimit;
- c. Shënohen të gjitha institucionet të tjera (nëse ka) që do të bashkëpunojnë për realizimin e projektit, me të cilët Agjencia Ekzekutuese (IAL) ka nënshkruar marrëveshje, para paraqitjes së projekt-propozimit.
- d. Vazhdohet me titullin e projektit i cili duhet të jetë në shqip dhe anglisht.
- e. Plotësohet Fusha e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit, të përcaktuar në thirrjen përkatëse.
- f. Shënohet emri i drejtuesit të projektit dhe i përfaqësuesit të sipërmarrjes së biznesit;
- g. Njësia bazë që bën propozimin (departamenti, sektori, fakulteti apo qendra shkencore) që do të realizojë apo do të drejtojë projektin;
- h. Jepet afati i realizimit të projektit, duke shënuar kohën e fillimit (muaji, viti) dhe të përfundimit të tij (muaji, viti). Koha e përfundimit përfshin paraqitjen e raportit përfundimtar në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.
- i. Plotësohet vlera në Lekë (jo në monedhë tjetër) e shumës së kërkuar nga AKKSHI përfshirë në të vlerën e TVSH-së. Më pas vlera në lekë e buxhetit të siguruar nga burime të tjera si dhe vlera totale e projektit.
- j. Plotësohet vlera në Lekë (jo në monedhë tjetër) e shumës së financimit nga sipërmarrja e biznesit përfshirë në të vlerën e TVSH-së.
- k. Vijohet me plotësimin e të dhënave të personave që do të marrin pjesë në realizimin e projektit.
- l. Bëhet identifikimi i problemit dhe argumentohet rëndësia e zgjidhjes së tij. Në këtë kuadër duhet të sqarohen çështje të tilla si:
  - i.gjendja e deritanishme ose njohja e problemit para ndërmarrjes së projektit;

- ii. arsyet përse ndërmerret projekti dhe çfarë synohet të zgjidhet në kuadër të tij;
  - iii. alternativat e zgjidhjes së problemit;
  - iv. të rejat që pritet të sjellë projekti në planin shkencor dhe/ose teknologjik;
  - v. ndikimi ekonomik, social, ekologjik, etj., i zgjidhjes së problemit;
  - vi. a janë të komercializueshme rezultatet e pritshme të projektit;
  - vii. a është e domosdoshme që projekti të ndërmerret në këtë moment;
  - viii. përveç institucionit që ndërmerr studimin, kujt tjetër i interesojnë rezultatet e pritshme të projektit për zbatim;
  - ix. përse projekti duhet të financohet nga buxheti i shtetit, etj..
- m. Jepen punimet shkencore të kryera deri tani në këtë fushë ose që janë në proces nga institucione të tjera shkencore brenda ose jashtë kuadrit të PBIB, si dhe lidhja që ato kanë me projektin që do të ndërmerret, me qëllim që të shmanget përsëritja ose kryerja e punëve paralele.
  - n. Jepen punimet shkencore të kryera ose që janë në proces në këtë fushë nga njësi të tjera (grupe kërkimore, sektorë, etj.) në vetë Agjencinë Ekzekutuese brenda ose jashtë kuadrit të PBIB, që kanë lidhje me projektin që do të realizohet, me qëllim që të shmangen paralelizmat dhe njëkohësisht të shfrytëzohen rezultatet e tyre.
  - o. AKKSHI kërkon të sigurojë që parimet më të larta të rigorozitetit të kërkimit akademik dhe kërkimit shkencor të ndiqen në të gjitha projektet. Prandaj, vlerësuesit do të vlerësojnë propozimet për pajtueshmërinë me parimet e mëposhtme:
    - i. Zhvillimi i pyetjeve të rëndësishme që mund të hetohen në mënyrë empirike.
    - ii. Lidhja e kërkimit me teorinë përkatëse.
    - iii. Përdorimi i metodave që trajtojnë drejtpërdrejt çështjen e interesit.
    - iv. Një zinxhir arsyetimi koherent dhe i qartë.  
Një standard i përgjithshëm me kërkimin ekzistues dhe kontekstet kërkimore.
    - v. Publikimi i hulumtimeve për të nxitur kritikën profesionale.
    - vi. Konkretisht për këtë program, paneli shqyrtues do të vlerësojë të gjitha propozimet sipas kritereve të mëposhtme:
    - vii. Cili është potenciali që projekti i propozuar të monitorojë, vlerësojë dhe/ose adresojë në mënyrë efektive problematikën?
    - viii. A demonstroi qartë projekti i propozuar një bashkëpunim të dobishëm midis një partneri biznesi dhe një partneri kërkimor akademik?
    - ix. A ka një përshkrim të qartë të objektivave dhe arritjeve të projektit?
    - x. A ka një përshkrim të qartë të përkufizimit të suksesit të projektit?
    - xi. A është buxheti i propozuar i arsyeshëm për aktivitetet dhe afatin kohor të propozuar të projektit?

- xii. A është plani për kryerjen e aktiviteteve të propozuara i arsyetuar, i mirëorganizuar dhe i bazuar në arsyetim të shëndoshë?
  - xiii. Sa i kualifikuar është ekipi i projektit për të kryer aktivitetet e propozuara?
  - xiv. A ka një rrugë të mirëpërcaktuar drejt komercializimit dhe/ose mundësi tregu në dispozicion për teknologjinë e propozuar?
  - xv. A ka ekipi i projektit ekspertizën dhe përvojën thelbësore për të rritur gjasat e rezultateve pozitive tregtare?
- p. Pika 4 - Jepet qëllimi dhe Objektivat e projektit. Jepet objektivi i zhvillimit të projektit, që shpreh një pikësynim të rëndësishëm në lidhje me zhvillimin e kërkimeve në fushën përkatëse, në funksion të realizimit të përfitimeve të rëndësishme për sektorin e ekonomisë të cilit ai Biznes i përket.
  - q. Jepen qëllimi dhe objektivat e projektit. Ato duhet të jenë të shprehura në mënyrë koncize dhe të saktë, duke vënë në dukje progresin që do të arrihet në krahasim me gjendjen para projektit. Duhet të mënjahen objektivat me karakter të përgjithshëm, ato duhet të jenë konkrete. Arritja e tyre duhet të shprehet me rezultate të matshme e të kontrollueshme me indikatorë sasiorë e cilësorë, që mund të arrihen me aktivitete brenda mundësive të financimit. Çdo objektiv mund të ketë një ose disa rezultate. Mundet që një rezultat të mbështesë më shumë se një objektiv.
  - r. Pasqyrohen aktivitetet që do të kryhen për të arritur rezultatet e kërkuara (sipas formatit të dhënë). Çdo rezultat duhet të mbështetet të paktën nga një aktivitet. Për çdo aktivitet përcaktohet kohëzgjatja (muaj, javë, etj).
  - s. Paraqitet ndarja e fondeve (shpenzimeve) sipas zërit të veçantë në tabelën e formatit të buxhetit (shiko *Aneks 2*).

## **ANEKS 4**

### **LISTA E DOKUMENTAVE TË PARAQITURA BASHKË ME PROJEKT PROPOZIMIN**

Aplikantët duhet të dorëzojnë:

- Projekt propozimin të hartuar dhe paraqitur vetëm sipas formularit standard të aplikimit për PTI (shiko Udhëzues PTI);
- CV e Drejtuesit të projektit, i cili duhet të ketë të paktën gradën “Doktor” në fushën përkatëse;
- Kopje të diplomës së gradës shkencore apo titullit akademik të drejtuesit të projektit;
- Miratimin e titullarit të Institucionit të Arsimit të Lartë për pjesëmarrje në projekt;
- Vetëdeklarim i IAL-së aplikuese që janë shlyer të gjitha detyrimet pranë AKKSHI nëse ka qenë më parë përfitues i fondeve të AKKSHI-së;
- Vendimin e akreditimit të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë që aplikon;
- Marrëveshje partneriteti dhe bashkëfinancimi midis IAL dhe sipërmarrjes së biznesit partner për realizimin e projektit.
- NIPT (biznesit);
- Vërtetim nga zyra e tatim taksave, që vërteton që institucioni nuk ka detyrime të prapambetura tatimore dhe të sigurimeve shoqërore;
- Kopje të statutit apo ekstraktit të QKR
- Përshkrimi i infrastruktures apo paisjeve teknike që ka në zotërim ndërmarrja/biznesi aplikues, të cilat kanë rendësi për realizimin e projektit të propozuar;